



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 106/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Xhevdet Abazi, kryesues, Rafet Haxhaj dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e Albina Dina, lidhur me tërheqjen nga lista si kandidate për Anëtare të Kuvendit të Komunës në Rahovec nga Iniciativa Qytetare Ndryshe, për zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET apeli si i palejueshëm i Albina Dina, kandidate Anëtare të Kuvendit të Komunës në Rahovec nga Iniciativa Qytetare Ndryshe.

Arsyetim

Me datën 19.09.2013 PZAP-i ka pranuar një apel nga Albina Dina, kandidate për Anëtare të Kuvendit të Komunës në Rahovec nga Iniciativa Qytetare Ndryshe në të cilën kërkon që të tërhiqet nga lista për anëtare të kuvendit komunal në Rahovec, pasi që ajo nuk ka qenë në dijeni se pjesëmarrja e saj në garë si kandidate për anëtare të kuvendit komunal do ti ndërpritet paga e punës.

Lidhur me këtë PZAP-i e informoi KQZ-në për apelin e ushtruar ndaj vendimit të saj dhe kërkoj nga KQZ-ja që të përgjigjet deri me datë 20.09.2013, me të njëjtën datë KQZ-ja përgjigjet se “Iniciativa Qytetare Ndryshe” ka aplikuar për certifikim me datën 04.09.2013, ku në formularët e kandidatëve të Inicativës Qytetare Ndryshe duke e përfshirë edhe formularin e kandidates Albina Dina ka qenë në pajtueshmëri me nenin 29.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), si dhe me datën 10.09.2013 KQZ ka certifikuar Inicativën Qytetare duke e përfshirë edhe kandidaten Albina Dina me nr. rendor 03.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i gjeti se apeli është i **palejuar**:

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku dispozitat ligjore përcaktojnë që subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit.

KQZ-ja me datën 19.09.2013, e ka hedhur shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotime për Zgjedhjet Lokale të datës 03.09.2013. Andaj pala e cila ka parashtruar apel në PZAP nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e kërkesës për tërheqje në KQZ sipas nenit 28.5 të LZP-së. Me qenë se pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lartcekur për tërheqje nga lista e kandidatëve por ka parashtruar drejtpërdrejt apel në PZAP gjë që nuk është e lejuar sipas LZP-së, PZAP-i, vendosi se apeli është i palejuar prandaj duke u bazuar në nenin 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 106/2013 më datën 25.09.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdot Abazi**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*